



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE

Nr. 145 Prot

Tiranë, më 13/012023

Lënda Raporti vjetor Agjencia e Trajtimit të Kredive Viti 2022,
Planveprimi për Vitin 2023

Drejtuar: Znj. Adela XHEMALI

ZV. MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Znj. Olta MANJANI

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË ATK-SË

Të nderuar,

Në zbatim të Ligjit Nr. 8894, datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 33, datë 24.09.2010 dhe Rregullores së Funksionimit të Brendshëm të Agjencisë së Trajtimit të Kredive, në vijim të procesit të raportimit, ju paraqesim raportin vjetor, për periudhën Janar - Dhjetor 2022, sidomos mbi realizimin e treguesve financiar dhe statistikor, si dhe një strategji për Planveprimin e Vitit 2023.

HYRJE

Performanca e ATK-së, në realizimin e objektivave u orientua sipas planit të miratuar nga Këshilli Mbikqyrës për Vitin 2022 dhe sipas pikave si më poshtë:

Realizimi me sukses i këtij misioni ka prioritet në:

- Zgjidhjen me sukses për kërkesat ndaj debitorëve
- Trajtimi ligjor i dosjeve
- Nxjerrja e pronave në ankand nga Sektori i Menaxhimit të Riskut
- Marrëveshjet ndërinstitucionale

➤ **Treguesit e arkëtimeve dhe performancës, sqarime mbi to**

Në kuadër të realizimit të objektivave për Vitin 2022, siç ju kemi vënë në dijeni edhe në

raportimet mujore, ATK-ja ka vënë në funksion masat administrative, për të përmirësuar punën dhe zgjidhur problematikat e krijuara, të mbartura, por edhe gjatë vitit që sapo u mbyll. Është vijuar me intensitet puna për arritjen e objektivit kryesor të Agjencisë, realizimin e planit, i cili pati një ecuri të mirë përsa u përket arkëtimeve për 3-mujorin e katërt të vitit (Tetor – Nëntor - Dhjetor), duke pasur parasysh edhe faktin se Sektori Juridik e Operacional ka pasur vështirësi të trashëguara nga situata të paparashikuara si pandemia apo kriza.

Një vëmendje e posaçme i është kushtuar etapave të ndjekjes ligjore dhe trajtimit të huamarrësve. Krahas detyrave operacionale në terren, rëndësi i është kushtuar edhe trajtimit ligjor, ku janë dërguar 2578 “Njoftime Detyrimi” për debitorët dhe nënshkruar 160 kontrata të reja me përmbaruesit privatë dhe shtetërorë. Ka pasur një volum kolosal në trajtimin e shkresave, ku si drejtori janë marë në shqyrtim 3467 shkresa, 1239 hyrëse dhe 2228 dalëse. Theksojmë se rezultati në realizimin e përqindjes aktuale ka ardhur si rrjedhojë e arkëtimeve dhe nuk ka pasur shitje prone siç ka ndodhur në vitet paraardhëse. Në të tilla kushte, vlen të theksohet se, duke pasur parasysh amortizimin e portofolit, realizimi i planit ka pasur një trend pozitiv, për shkak të natyrës delikate dhe të vështirë të veprimtarisë së institucionit tonë si dhe një sërë problematikave të natyrave të ndryshme që janë trajtuar rast pas rasti.

- **Gjatë Vitit 2022 janë ekzekutuar 129 dosje të debitorëve të ATK-së, 10 më shumë se një vit më parë.**
- **Realizimi i të ardhurave nga arkëtimet e detyrimeve të debitorëve për periudhën Janar - Dhjetor 2022 është si më poshtë:**

Progresiv Janar - Dhjetor 2022

Plan	Fakt	%
90,000,000 All	62.219.009 All	69.13

Në vitin që u mbyll është realizuar pagesa e një pjesë detyrimi të prapambetur për KFË-në, në shumën 268.000 Euro dhe synohet që në vijim, me realizimin e targetit në një përqindje sa më të lartë, të ketë sërish përpjekje për të shlyer tjetër kështë të konsiderueshëm.

➤ Problematikat dhe zgjidhja

Gjatë Vitit 2022, janë caktuar detyra me plane afatshkurtër dhe afatgjatë për trajtimin e të gjithë debitorëve në ekzekutim, të cilat në përfundim rezultuan efikase në realizimin e planit në masën 69,13%. Prioritet ka qenë edhe dërgimi e ndjekja për ekzekutim në zyrat e shërbimit përmbarimor, shtetëror dhe privat i praktikave të debitorëve.

Nga analiza e bërë, gjatë Vitit 2022 nuk pati arkëtime të konsiderueshme nga Përmbaruesit Gjyqësorë Privatë, pjesa dërmuese e të cilëve nuk duan më bashkëpunim me ATK-në dhe kemi konstatuar vështirësi në gjetjen e përmbaruesve të tjerë që pranojnë të ekzekutojnë dosjet. Pranë shërbimit përmbarimor privat, janë për ekzekutim të detyrueshëm rreth 1456

dosje dhe pranë atij Shtetëror rreth 100 dosje. Pritet që të dërgohen në ekzekutim afro 200-300 dosje në Zp Shtet ose Privat, qoftë edhe të rikthyera nga zyrat e tjera që nuk kanë pasur sukses në trajtimin ligjor në periudhën Janar - Mars 2023, të cilat ndikojnë në plan.

Problematikë që ka ndikuar në planin operacional janë edhe lëvizjet në terren. Referuar aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, si dhe vendimit nr.160, datë 14.3.2022 të Këshillit të Ministrave nga ana e Agjencisë së Trajtimit të Kredive, janë marrë të gjitha masat në: Minimizimin e shpenzimeve për transportin e punonjësve, për lëvizjet brenda dhe jashtë Tiranës në realizimin e detyrave funksionale në masën 50% të parashikimit të bërë për buxhetin e Vitit 2022. ATK ka 3 automjete funksionale dhe me hyrjen në fuqi të VKM-së sa më sipër, lëvizjet kanë qenë të orientuara sipas një grafiku javor, të hartuar nga Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, referuar edhe planit javor të Sektorit Juridik dhe Operacional që një nga funksionet bazë të detyrave ka kontaktin me debitorët në terren.

Lëvizjet në pjesën më të madhe të vitit kanë qenë të kushtëzuara dhe të fokusuara te takimi me debitorët konkretë (të sigurtë në pagesa), si dhe në përfaqësimin e ATK-së në proceset gjyqësore në rrethe, ku specialisti që ka ndjekur procesin ka arritur që të kryejë edhe takimet me debitorët në terren. Kjo procedurë ka ndikuar edhe në veprimtarinë e ATK-së, konkretisht në planin operacional, sidomos në përqindjen e realizimit të arkëtimeve të planit vjetor.

Tjetër problematikë që është hasur dhe ka pasur ndikim ka të bëjë me procesin e transferimit të zyrave. Si edhe ju kemi bërë me dije, me VKM-në, Nr.49, datë 26.01.2022, “Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit nga Agjencia e Trajtimit të Kredive tek Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të pasurisë Nr. 7/115, zona kadastrale 8270, Tiranë dhe për një ndryshim, në vendimin nr.20, datë 19.01.2007 të Këshillit të Ministrave”, administruar në ATK me Nr.308 prot., datë 28.01.2022, jemi vënë në dijeni për vijimin e procedurës për kalimin në përgjegjësi administrimi të ambienteve të katit të parë të godinës me numër pasurie 7/115, zona kadastrale numër 827, nga Agjencia e Trajtimit të Kredive tek Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Referuar VKM-së sa më sipër, nga ana jonë u ndoq procedura dhe u morën masat për gjithë procesin e zhvendosjes, duke ndjekur me prioritet dhe monitoruar lëvizjen në mënyrë që të mos cënohej qoftë dokumentacioni dhe sidomos dosjet fizike të ndodhur në arshivë, ashtu edhe “Serveri” që janë të rëndësishë së veçantë.

Duke qenë një procedurë delikate, prej afro një muaj çdo specialist sipas sektorëve në varësi u angazhua në sistemimin jo vetëm të bazës materiale, por edhe dokumentacionit në ngarkim.

Nisur edhe nga veprimtaria afro 30-vjeçare, natyrisht që ka filluar që të ndihet edhe “tkurja” e portofolit në zona të caktuara dhe ATK po përpiket me të gjithë instrumentat ligjore në trajtimin rast pas rasti, madje edhe duke iu rikthyer rasteve kur kërkojnë analizë të veçantë.

Portofoli dhe numri i debitorëve të mbetur për trajtim ka nisur që të grupohen e klasifikohen, sikundër është vepruar konkretisht deri tani; pra, sipas madhësisë së detyrimit, objektit të kredisë, llojit të kolateralit e kështu me radhë. Bazuar tek objekti i kredisë, numrin më të madh e zënë debitorët e zonave rurale, ku vetëm ata me objekt kredie “për bujqësi e blegtori” dhe “për mjete bujqësore” shkojnë në total në 5000 praktika kredie. Synohet që në periudhën Janar - Mars 2023 të kenë prioritet këto raste, pasi edhe arkëtimet janë më të realizueshme duke qenë se nuk janë shuma të konsiderueshme dhe arkëtohen më lehtë.

Grupet e punës në terren kanë vijur punën duke verifikuar kolaterale të lëna nga debitorët si garanci për marrjen e kredisë, të cilat në shumicën e rasteve kanë parregullsi dokumentacioni. Nga verifikimet që po realizohen dhe nga përgjigjet e marra nga përmbaruesit, pas vënies në ekzekutim të dosjeve, është evidentuar se shumë nga debitorët kanë ndërruar jetë. Çelja e dëshmisë së trashëgimisë është gjithashtu një proces që kërkon kosto, krahas edhe pasurive të cilat janë në bashkëpronësi apo tokë bujqësore dhe sipas ligjit nevojitet veçimi i pjesës takuese. Jemi duke bërë vlerësime rast pas rasti në funksion të përfitimit ekonomik që ka Agjencia, duke realizuar arkëtimet me kosto sa më të ulët.

Problematikë mbetet edhe rritja e numrit të proceseve gjyqësore, të ngritura nga debitorët, me objekt-padie për: “pavlefshmëri titulli detyrimi” për pretendim të plotësimit të afatit të parashkrimit, për shkak se janë kredi të cilat janë dhënë para më shumë se 25 viteve. Proceset gjyqësore ndiqen me prioritet nga ana e institucionit, ku përfaqësohemi në çdo seancë, me synim rikuperimin e debisë. Vëmë në dukje se institucioni ynë përfaqësohet në çdo proces, në çdo gjykatë të Rrethit Gjyqësor në rang vendi, apo dhe Gjykatat e Apelit, duke ndjekur procedurën ligjore. Për periudhën Janar-Dhjetor 2022, ATK është përfaqësuar në 55 procese, ose 238 seanca gjyqësore, sipas grafikut si më poshtë:

Janar - Dhjetor 2022	
Procese të zhvilluara	55
Seanca të përfaqësuara	238
Procese të fituara në Gjykatën e Shkallës së Parë	7
Procese të fituara në Gjykatën e Apelit	3

➤ Sektori i Riskut dhe ankandet

Sektori i Riskut gjatë Vitit 2022 është fokusuar kryesisht në kryerjen e detyrave të mëposhtme:

- Regjistrimin e të dhënave të debitorëve në sistemin live të Bankës së Shqipërisë

Në vijim të bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë, si rezultat i dërgimit të emrave në të gjitha bankat e nivelit të dytë, ka pasur reagim nga debitorë të cilët janë detyruar që të paguajnë detyrimin pranë ATK-së, pasi rezultojnë si debitorë “të këqinj”. Nga institucioni po vijohet me dërgimin e të tjerë debitorëve, dhe pritet që të ketë një numër të konsiderueshëm në 3-mujorin e parë të Vitit 2023, në mënyrë që ata të mos marrin kredi pa mbyllur detyrimin në ATK.

- Shqyrtimin e raporteve të vlerësimit të pronave në pronësi të ATK-së

Gjatë Vitit 2022, sektori ka shqyrtuar raportet e vlerësimit të pronave të ndryshme nën pronësi të ATK-së, si dhe ka vijuar me verifikimin e dosjeve në rast se një pronë do të konsiderohej e përshtatshme për t'u nxjerrë në ankand. Sipas listës së objekteve të sekuestruara deri në datën 31.12.2021, ATK ka në pronësi 77 prona, ose e shprehur në vlerë 129,294,240.05 lekë. Ne kemi shqyrtuar raportet e secilës prej këtyre pronave të zonave të ndryshme. Pronat janë analizuar nga ana e pozitës gjeografike, zhvillimit ekonomik të zonës dhe infrastrukturës rrugore.

Gjatë Vitit 2022 janë hedhur ankandet për debitorët si më poshtë:

- Aleks Kosta, Përmet

Faza e parë (13/06/2022 - 04/07/2022)

Faza e dytë (18/07/2022 - 08/08/2022)

Faza e tretë (26/09/2022 - 17/10/2022)

- Defrim Bicaj, Gramsh

Faza e parë (26/09/2022 - 17/10/2022)

Faza e dytë (24/10/2022 - 14/11/2022)

Faza e tretë (21/11/2022 - 12/12/2022)

Asnjë nga ankandet e mësipërm nuk ka pasur ofertues (pra, në 6 faza ankandesh) dhe si rrjedhojë nuk ka pasur as shitje prone.

Duhet theksuar se, shumica e pronave kanë mungesë të infrastrukturës dhe janë në pozicione gjeografike të cilat e bëjnë të vështirë gjetjen e një blerësi potencial.

• Regjistri Pasiv

Nga sektori janë shqyrtuar dosjet e debitorëve, të cilët gradualisht duhet të regjistrohen në "Regjistrin Pasiv". Të dhënat e kërkuara lidhen kryesisht me zyrat përmbarimore, urdhërat e ekzekutimit, debitorët me vendim gjykate, kolateralet dhe zonat të cilave ata u përkasin. Kjo është një detyrë që kryhet në bashkëpunim me Sektorin Juridik dhe Operacional.

➤ Marrëveshjet ndërinstitucionale

Nga bashkëpunimi ndërinstitucional me Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit Shtetëror, është më i lehtë evidentimi i debitorëve dhe ekzekutimi i detyrimit, pasi në qytetet ku ushtrojnë funksionin na suportojnë për realizimin e arkëtimeve, në orientimin për kontaktin e drejtpërdrejtë me debitorin.

Po bashkëpunohet me 61 Bashkitë në rang vendi duke kërkuar mbështetje edhe nga Njësitë Administrative për saktësimin e adresave të debitorëve dhe çdo Administrator i Njësisë na suporton në terren, pas ka kontakt të drejtpërdrejtë me komunitetin që përfaqëson. Sa më sipër, Sektori Juridik, tashmë ka një informacion më të detajuar dhe kontakt me debitorin.

Kemi nisur një bashkëpunim me DPSHTRR, për njoftimin e debitorit për detyrimin që ka ndaj ATK-së dhe pezullimin e tjetërsimit të automjeteve të regjistruara në emër të debitorit. Me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, kemi kërkuar bashkëpunim për njoftimin e debitorit, për detyrimin që ka ndaj ATK-së dhe dhënien e informacionit në lidhje me çdo aktivitet fitimprurës të regjistruar, njoftimin për debitorët persona juridikë dhe informimin në lidhje me gjendjen e aktivitetit të tyre.

Synohet në vijim realizimi i marrëveshjes së bashkëpunimit edhe me Postën Shqiptare për adresimin më të saktë të zarfave të “Njoftimit të detyrimit”, por edhe me OSHEE e UK SHA, apo dhe Policinë e Shtetit. Në këtë mënyrë do të kemi një rrethanë lehtësuese dhe mundësi më tepër, në kontaktin e drejtpërdrejtë me debitorin, sidomos të migruarit.

➤ Strategjia

Strategja për Vitin 2023, për realizimin e planit:

Për 3-mujorin e parë janë parashikuar arkëtimet të ndara sipas muajve si më poshtë:

Plani i 3-mujorit të parë të Vitit 2023	(mijë lekë)
Janar	6,900
Shkurt	7,200
Mars	7,550

Në vijimësi të funksionimit të veprimtarisë së ATK-së, lind nevoja e përmirësimit dhe organizimit eficient të punës, sidomos në zgjidhjen e problematikave që dalin gjatë ekzekutimit të debitorëve kundrejt ATK-së:

1. U krye një riorganizim total në lidhje me zonat, ku të 7 Specialistët do të kenë në portofolet e tyre një numër të barabartë debitorësh, por edhe si detyrim për të rikuperuar.
2. Organizimin e grupeve të punës në terren në kontakt me debitorin, trajtimin dhe realizimin e planit të arkëtimeve, por sidomos me prioritet debitorët potencial, që kanë ndikim të konsiderueshëm në targetin e JSO-ve.
3. Dërgimin e rasteve të reja dhe ndjekjen çdo muaj pranë zyrave të shërbimit përmbarimor privat ose shtetëror. Rritja e kërkesës së llogarisë dhe bashkëpunimit me këto zyra.
4. Grupimi i dosjeve me Urdhër Ekzekutimi fotokopje, për të cilat duhen njehësuar me origjinalin ose lëshimi i dublikateve pranë gjykatave përkatëse, në mënyrë që të aktivizohen për trajtim ligjor pranë zyrave përmbarimore.
5. Evidentimi në mënyrë konstante i fazave të dosjeve të debitorëve që janë në ekzekutim pranë zyrave përmbarimore private dhe shtetërore.
6. Aplikimi dhe nxjerrja e dokumentave të pronësisë për të gjitha pasuritë e paluajtshme të kaluara në pronësi të ATK-së dhe të freskohen dokumentet e pronësisë për ato pasuri që janë me dokumenta të paazhornuara në sistemet e ASHK-ve.
7. Verifikim fizik dhe analizë e pronave me kolateral dhe të kaluara në pronësi të ATK-së.
8. Rikuperim i procesve gjyqësore, ndjekja sipas zonave, zbatimi i procedurës sipas fazave

ligjore, përpjekje maksimale për rekuperimin e tyre.

Stafi aktual i ATK-së, në bashkëpunim edhe me sektorët përgjegjës e ka ndërtuar strategjinë e punës, që të shërbejë jo vetëm në realizimin e një muaji. Për sa më sipër, në lidhje me realizimin e planit të hartuar mes sektorëve dhe angazhimit të Specialist/Jurist dhe Operacional në terren pritshmëritë janë të mëdha. ATK ka ende një numër të konsiderueshëm dosjesh në ekzekutim, apo dhe debitorë të cilët mbahen të evidentuar për t'u kontaktuar nga juristi që mbulon zonën.

Konkluzione: Sipas vlerësimit tonë fokusi i punës së Agjencisë së Trajtimit të Kredive duhet të jetë identifikimi i debitorit dhe kontaktimi i tij. Natyrisht që ka filluar që të ndihet edhe "tkurrja" e portofolit në zona të caktuara dhe ATK po përpqet me të gjithë instrumentat ligjore në trajtimin rast pas rasti, madje edhe duke iu rikthyer rasteve kur kërkojnë analizë të veçantë. Gjatë Vitit 2022, plani i ATK-së është realizuar në masën 69,13 %, falë një bashkëpunimi mes sektorëve edhe pse ka qenë një vit post-pandemik. Pavarësisht ndikimit të faktorëve të mësipërm, realizimi i detyrave me plan afatmesëm, shtrirja e urave të bashkëpunimit me institucione të tjera, si dhe reflektimi apo një impenjim maksimal i sektorëve, pritet që të jetë efikas duke ndikuar në përmirësimin e rritjen e treguesve në muajt dhe vitin në vijim, duke synuar rezultate pse jo edhe më të larta.

Duke ju falënderuar, me konsideratë,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Eri Koshaj